



UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" UNIVERSITY
Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Rektori: Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi Ref.nr. 01/ 1287 dt. 29.09.2020

Mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Punës, Nr. 03/L-212, dispozitat e nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës, Nr. 04/L-037, si dhe nenit 158 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit "Kadri Zeka" Gjilan, Senati i Universitetit në mbledhjen e XII , të mbajtur më datë 17.09.2020, merr vendim për të shpallur:

K O N K U R S

Për zgjedhjen e një Ligjëruesi në marrëdhënie të rregullt pune për lëndët e Artit figurativ në Fakultetin e Edukimit të Universitetit "Kadri Zeka" Gjilan

Kandidatët të cilët paraqiten në konkurs duhet t'i dorëzojnë këto dokumente:

- Kërkesën;
- Biografinë (CV);
- Aplikacionin e plotësuar dhe nënshkruar F1 (Aplikacioni merret në ueb faqen e UKZ-së);
- Kopjen e diplomës të studimeve themelore, masterit dhe dëshmi për regjistrimin e studimeve të doktoratës, të noterizuara (kandidatët e brendshëm të UKZ-së nuk kanë nevojë të sjellin këto dokumente, përveç nëse janë të reja dhe nuk janë sjellur më parë);
- Certifikatën e notave të përgatitjeve shkollore nivelet e studimit;
- Certifikatën e lindjes;
- Certifikatën e shtetësisë (ose certifikatën për vendbanimin në Republikën e Kosovës) ;
- Dëshmi (kopjet) për krijimtarinë artistike, teksteve mësimore, publikime në revista ndërkombëtare shkencore ose artistike etj.
- Dëshmi për përvojën e punës në mësimdhënie dhe profesione tjera lidhur me fushën e mësimdhënies në arsimin e lartë;
- Çertifikatë nga gjykata, se ndaj tij nuk janë duke u zhvilluar hetime;
- Dëshmi për njohjen e gjuhës së huaj botërore.

Kandidatët që kanë përfunduar studimet baçelor apo master jashtë vendit duhet të sjellin dëshmi për nostrifikimin e diplomës përkatëse nga MASHT-i .

Kandidatët duhet të sjellin njërin prej këtyre dokumenteve si dëshmi për njohjen e gjuhës së huaj botërore:

1. Të kenë të kryer njërin nivel të studimeve në gjuhën e huaj ose certifikatë IELTS, TOEFL, TOEIC apo ndonjë dokument tjetër të vlefshëm.

Kandidatët duhet t'i plotësojnë të gjitha kushtet e parapara me Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr.04/L-037, Statutin e Përkohshëm të Universitetit "Kadri Zeka" Gjilan, (shih:https://www.uni-gjilan.net/ep-content/uploads/2017/06/Statuti_i_P%C3%ABrkoresh%C3%ABm_i_Universitetit_Publik_t%C3

[%AB_Gjilanit_110471-1.pdf](#)) dhe Rregullores, Nr.01/625 dt.12.06.2020 për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë, nga dita e publikimit në ueb-faqe.

Paraqitja e dokumenteve bëhet në zyrën nr. 4.

Aplikantët duhet të plotësojnë formularin F1 të cilin mund t`a shkarkojnë nga ueb-faqja e universitetit, dhe në mënyrë elektronike së bashku me dokumentet e tjera e dërgojnë në info@uni-gjilan.net si dhe i tërë dokumentacioni sjellët në kopje fizike në UKZ.

Aplikacionet e arritura pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim. Konkursin mund ta gjeni të publikuar edhe në ueb faqen zyrtare të universitetit:
<http://www.uni-gjilan.net>